

ENGJËLL ANGONI

PJESËZAT NË GJUHËN SHQIPE *

Përkufizimi dhe veçoritë leksiko-gramatikore të pjesëzave

Pjesëzat janë fjalë shërbyese, pjesë të pandryshueshme të ligjëratës, që shërbejnë për të shprehur nuanca kuptimore plotësuese dhe për të përcaktuar qëndrimin e folësit. Ato shërbejnë gjithashtu për të theksuar anën emocionale të të folurit dhe për të rritur fuqinë shprehëse të tij. P. sh.

a) pjesëza që shërbejnë për të shprehur nuanca kuptimore plotësuese (të një fjale, të një togfjalëshi a të një fjalie të tërë): Nesti e frenoi menjëherë autokambajnën e, duke u ngritur në këmbë, klithi nga gëzimi: — Mitri, *po vjen, po vjen*, shiko atje! (N. Prifti, Një pushkë, 99), *Pikërisht* në këtë mënyrë forca luftarake e çdo anëtarit të partisë do të rritet më shumë. (E. Hoxha, Raport në Kong. V, 99), *Vetëm* kur mbaroi këtë ceremoni, iu afrua trupit të të birit. (N. Prifti, Një pushkë, 26);

b) pjesëza që shërbejnë për të shprehur qëndrimin e folësit:

— *Mos ik*, qëndro dhe pak, — dhe befasi dora e tij leshtore rrëshqiti nga supi. (A. Abdihoxha, Tri ngjyrat, 13); Emira: (Mendohet) *Ndoshta* erdhi koha që të iki edhe unë nga shtëpia. (F. Paçrami, Dy, 9);

c) pjesëza që shërbejnë për të theksuar anën emocionale të të folurit dhe për të rritur fuqinë shprehëse të tij: Shokë, *seç* na mori malli! (A. Shehu, Vite, 17), — *Po me se lave pa?* (F. Gjata, Tana, 53).

Pjesëzat nuk përdoren të mvetësishme dhe nuk kanë kuptim leksikor të pavarur. Kuptimi leksikor i tyre është i kushtëzuar. Ai del nga konteksti. Disa pjesëza si *po*, *jo* etj. mund të përdoren edhe të veçara, me vlerën e një fjalie të pazbërthyeshme dhe të paanalizueshme në gjymtyrë të veçanta, por edhe në këto raste kuptimi i pjesëzave kushtëzohet nga përmbajtja e kontekstit. P.sh. *Po kështu — i tha — as kështu nuk të zuri? — Jo* (F. Arapi, Patat, 105), — *Të jenë gjermane? — Ndofta*. (A. Mara, Brumi, 35). Me vlerën e një fjalie pjesëzat përdoren rrallë, zakonisht në të folurit me dialog. Gjymtyrë të veçanta të fjalisë ato nuk mund të merren, sepse janë fjalë shërbyese.

Pjesëzat kanë disa veçori të përbashkëta me parafjalët dhe lidhëzat. Mungesa e kuptimit leksikor të pavarur, mungesa e aftësisë emërtuese dhe e treguesvet të posaçëm gramatikorë, pamundësia për të qenë gjymtyrë të veçanta të fjalisë dhe për t'u përdorur të mvetësishme janë veçori që i afrojnë pjesëzat me parafjalët dhe me lidhëzat. Por midis pjesëzave, nga njera anë, dhe parafjalëve e lidhëzave, nga ana tjetër,

*) Ky artikull përbën variantin e parë të kapitullit përkatës të morfologjisë së tekstit të «Gramatikës shkencore të shqipes».

ka edhe ndryshime, të cilat na japin mundësi të bëjmë dallimin e këtyre kategorive të veçanta, leksiko-gramatikore. Parafjalët dhe lidhëzat shprehin marrëdhënje gramatikore. Këtë funksion të përcaktuar të parafjalëve dhe lidhëzave, si fjalë shërbyese, pjesëzat nuk e kanë. Parafjalët dhe lidhëzat, ndryshe nga pjesëzat, nuk mund të përdoren as për të shprehur nuanca kuptimore plotësuese, modale a emocionale-shprehëse.

Pjesëzat afrohen edhe me ndajfoljet, sepse, krahas të tjerave, janë fjalë të pandryshueshme. Megjithatë ndajfoljet dallohen qartë nga pjesëzat në disa drejtime: nga kuptimi, nga funksioni dhe nga mjetet e formimit. Ndajfoljet janë fjalë emërtuese, kanë kuptim leksikor të parvarur, janë gjymtyrë të veçanta të fjalisë dhe mund të krijohen edhe me elemente fjalëformuese (parashtesa e prapashtesa). Pjesëzat kanë veçori të tjera leksiko-gramatikore.

Vendi dhe theksimi i pjesëzave

Sipas vendit të zenë në fjali pjesëzat janë dy llojesh: pjesëza me vend të ngulitur dhe pjesëza me vend të lirë. Pjesëzat me vend të ngulitur a të përhershëm mund të jenë:

a) gjithmonë të paravendosura, d.m.th. gjithmonë para fjalës a togfjalëshit të dhënë për të shprehur nuancat kuptimore përkatëse (*nuk, nja, desh, sapo* etj.);

b) gjithmonë të pasvendosura, d.m.th. gjithmonë pas fjalës a togfjalëshit të dhënë (*de, dot* etj.).

Numri i pjesëzave të pasvendosura është shumë i kufizuar në krahasim me pjesëzat e paravendosura. Shumica e pjesëzave janë me vend të lirë, d.m.th. nuk kanë vend të ngulitur a të përhershëm në fjali (*vallë, a, bile, jo, posi, ama* etj.). Mund të përdoren në fillim, në mes dhe në fund të fjalisë, para ose pas fjalëve a togfjalëshve të cilëvet u përkasin. P.sh. Kush të jetë *vallë* ky që u gjet tani? (I. Kadare, Gjenerali, 48). *Vallë* kush do t'i marrë erë? (Mbledhës, II, 4), Do të kthehen, *vallë*, prapë në shtëpi? (M. Xhaxhiu, Lirika, 10, 1957). Kush do të jetë ky komisar *vallë*? (N. Prifti, Një pushkë, 12).

Pjesëzat nuk ndahen me presë nga fjalët e tjera të fjalisë. Vetëm kur shqiptohen me pauzë, ato përdoren me presë para ose pas tyre. P.sh. — *E po*, hape të shkretën! (Q. Buxheli, Kur qesh, 134) — Nuk është ashtu, *jo*. (Sh. Musaraj, Para, I, 387), Leka — Përkundrazi, sot mbas ca kohe erdha së bashku me Stefanin, se akoma më pëlqen, *po, po*, më pëlqen... (I. Uruçi, Studentja, 44).

Pjesëzat mund të jenë fjalë të theksuara ose të patheksuara. Me theks përdoren zakonisht pjesëzat shumëërrokshe (*vetëm, sidomos, ndoshta, vallë* etj.) dhe disa pjesëza njëërrokshe (*ja, jo* etj.). Pa theks janë zakonisht pjesëzat njëërrokshe (*nja, nuk, le, de, pra* etj.).

Disa pjesëza njëërrokshe përdoren edhe të theksuara edhe të patheksuara. Krahaso p.sh. A mund të qëndrojmë këtu? (A. Abdihoxha, Tri ngjyrat, 309), — Si të *mos* vija — tha ai dhe buzëqeshi (D. Agolli, Komisari, 129), — Alo, më jep Lizën. A? Liza je? Ka ardhur këtu një grua nga fshati. (E. Kadare, Një lindje, 165), — *Mos!*... — dhe nuk fola. U largova prej shokut pa e përshëndetur. (B. Levonja, Ditari, 173).

Pjesëzat lokucione mund të jenë gjithashtu të theksuara ose të patheksuara. Zakonisht ato janë të patheksuara (*le që, as që, e po, si nja* etj.). Të theksuara janë sidomos lokucionet e formuara me pjesëza të theksuara (*po që po, jo që jo, po se po* etj.)

Klasifikimi morfologjik i pjesëzave

Sipas ndërtimit morfologjik, pjesëzat janë fjalë të thjeshta, të përngjitura ose lokucione.

Fjalë të thjeshta janë pjesëzat *bash, bile, ja, jo, nuk, po, s', vallë* etj. Si të thjeshta do të merren edhe ato pjesëza të cilat etimologjikisht nuk janë të tilla, por nga pikëpamja e gjuhës së sotme shqipe ndjehen si të thjeshta. Kështu, p.sh., pjesëzat *as, dot* etj.

Fjalë të përngjitura janë pjesëzat *posi, nja, seç, thujse (pothujse), kushedi* etj. Numri i tyre është i kufizuar. Formohen nga bashkimi në një fjalë të vetme i dy ose më shumë fjalëve për shkak të përdorimit të gjatë e të vazhdueshëm të tyre pranë njera tjetrës. Ndër fjalët e përngjitura zakonisht njera është pjesëz ose lidhëz: a) pjesëz + ndajfolje (*posi* — *po* + *si*), b) numëror + lidhëz (*nja* — *një* + *a*), c) lidhëz + përemër (*seç* — *se* + *ç'*), ç) folje + lidhëz (*thujse, pothujse* — *thuj* + *se, po-thuj* + *se*) etj.

Pjesëza lokucione janë: *as që, ja që, jo që jo, po se po, pa le, se mos, vetëm që, vetëm e vetëm* etj. Formohen sidomos në dy mënyra: a) pjesëz e përsëritur dhe një lidhëz (*e, që, se*) si mjet bashkimi në mes tyre: *jo e jo, jo se jo, po që po, vetëm e vetëm* etj., b) pjesëz e bashkuar me një lidhëz: *as që, vetëm që, ja që* etj.

Shumica e pjesëzave të shqipes kanë dalë prej pjesësh të tjera të ligjëratës, sidomos nga lidhëzat (*dhe, edhe, porsa, pra, sa, sapo, se, sikur* etj.), ndajfoljet (*gati, plot, rreth, vetëm, veçanërisht* etj.) dhe pasthirrmat (*a, e, ë, de* etj.). Në ndonjë rast janë me prejardhje përemërore (*ç', sa*) ose foljore (*desh, le*).

Fjalët e pjesëve të ndryshme të ligjëratës, kur kalojnë në klasën e pjesëzave e humbasin ose e dobësojnë kuptimin leksikor. Ato humbasin gjithashtu funksionet e kategoritë gramatikore që mund të kenë pasur dhe në disa raste edhe theksin, nëse si fjalë emërtuese kanë qenë të theksuara. P.sh. pjesëza foljore *le* (trajtë e gjymtë e urdhërores së foljes *le* në vetën e dytë të njejësit), kur përdoret për ta paraqitur në formë nxitjeje, lejimi a pëlqimi urdhërin a veprimin e shprehur nga folësi me anën e foljes në kohën e tashme dhe të shkuar të mënyrës lidhore, e ka dobësuar thujse plotësisht kuptimin leksikor përkatës, ka humbur theksin, funksionin sintaksor dhe kategoritë gramatikore të foljes. Po kështu ndajfolja *vetëm*, kur përdoret si pjesëz, nuk ka më kuptim leksikor të pavarur dhe nuk është më gjymtyrë e veçantë e fjalisë që të shërbejë për të plotësuar kuptimin e foljes — kallëzues. Duke qenë pjesëz, ajo shërben si mjet i veçimit logjik të fjalës, të togfjalëshit a fjalisë, së cilës i përket dhe e ruan theksin. Krahaso p.sh. *Vetëm* shtëpia e Halilit qet një tym të hollë. (K. Jakova, Halili, 9), Gjyshja — Erdhe more Thanas? Mirë e bëre që erdhe, se edhe ne mëzitemi *vetëm*. (V. Kokona, Hijet, 64).

Klasifikimi i pjesëzavet sipas kuptimit

Sipas kuptimit pjesëzat ndahen në tri grupe kryesore:

1. pjesëza që shprehin nuanca të ndryshme kuptimore: dëftim, përcaktim a saktësim, kufizim, veçim, përforcim, përafërsi etj.;
2. pjesëza që shprehin nuanca modale: pohim, mohim, dyshim, mundësi, pamundësi, nxitje, pëlqim, dëshirë etj.

3. pjesëza që shprehin nuanca emocionale-shprehëse: gëzim, kënaqësi, habi, ironi, përbuzje, mospërfillje, hidhërim, keqardhje etj.

I. Pjesëza që shprehin nuanca të ndryshme kuptimore

Këto pjesëza shërbejnë për të shprehur nuanca kuptimore plotësuese të një fjale të veçantë, të një togfjalëshi a të një fjalie të tërë. Në këtë grup hyjnë pjesëzat: 1) dëftuese; 2) përcaktuese-saktësuese, 3) përforcuese dhe 4) përafëruese.

1) *Pjesëzat dëftuese*. Në këtë grup hyn vetëm pjesëza *ja*, e cila përdoret shumë dhe paraqitet me disa nuanca, si në gjuhën e folur edhe në të shkruarën. Shërben për të treguar dikë a diçka që gjendet e ndodh zakonisht në afërsi. P.sh. — Alvarez! *Ja* Katalonja. (P. Marko, *Hasta*, 338), — Vajzat? Ku janë? — *Ja*, një grumbull, në të djathtë të kullës së dytë. (I. Kadare, *Kështjella*, 157).

Kjo pjesëz përdoret edhe për të tërhequr vemendjen e bashkëbiseduesit, për të treguar afrimin e përmbushjen e diçkaje që dëshirohet a pritët të ndodhë. P.sh. — *Ja*, dëgjoje zërin e tij! (I. Uruçi, *Studentja*, 40), Vera — (duke hyrë), *Ja*, erdha. (F. Paçrami, *Tri*, 14).

Shpesh pjesëza *ja* përdoret kur ze fill tregimi a kallëzimi, ose kur ndodh diçka e papritur për folësin. P.sh. *Ja* si i tregonte vetë disa ngjarje të vegjëlisë së tij: ... (A. Xhuvani, *Jeta*, 10), *Ja* kështuzë një ditë më drekë, na e gjen Dodani çupën e zgjedhur te kroi i Kokovanos. (S. Andoni, *Tregime*, 23).

Pjesëza dëftuese *ja* mund të marrë edhe nuanca të tjera kuptimore. Kështu, p.sh., kur përdoret me përemra dëftorë, me ndajfolje, sidomos vendi, mënyre, shkaku etj., kjo shërben edhe për të saktësuar a përcaktuar më mirë kuptimin e tyre. P.sh. «*Ja* kësaj i thonë dasmë, *ja* kësaj i thonë nuse». (M. Kuteli, *Xinxifilua*, 124), — *Ja* kështu! — tha Tana me vete e çkuli me kujdes një panxhar aty rrëzë arës. (F. Gajta, *Tana*, 100), A po m'i jep mua, që t'i vemë *ja* atje në rrugicën e luleve, që të mos shkelin baltë. (S. Spasse, *Afërdita*, 10), Po i bëhet mirë ama. *Ja* tek e ka Lefkën në derë të shtëpisë. (Sh. Musaraj, *Isha unë*, 119).

Shënim: Sinonime me pjesëzën *ja* paraqitet pjesëza *qe*, por kjo ka përdorim të kufizuar. Përdoret kryesisht në të folmet e gegërishtes. P.sh. — kuptoj, shoku Sali, kuptoj. Do të punojmë, si kurrë. *Qe* dorën. (M. Gurakuqi, *Minjera*, 10), *Qe!* Shikoje! (S. Pitarka, *Trimi*, 11).

2) *Pjesëzat përcaktuese-saktësuese*. Këto pjesëza përcaktojnë a saktësojnë më mirë kuptimin e fjalës, të togfjalëshit a të fjalisë së cilës i përkasin. Në këtë grup hyjnë pjesëza *mu*, e cila zakonisht përdoret para fjalëve a togfjalëshve që shërbejnë në fjali si plotës vendi, mënyre a krahasimi, p.sh. Kur ike ti, yt atë plak, sakat e qorr të puthi *mu* në ballë (A. Çaçi, *Këngët*, 21), Por sa e bukur je lëndinë, Kur vesa zë shkëlqen mbi bar, Kur rrezet derdhen *mu* si ar. (Asdren, *Ëndra*, 120); pjesëzat *plot* dhe *rrumbullak*, të cilat shoqërojnë numërorët themelorë, p.sh. ... Kanë kaluar *plot* dy orë nga koha kur i duhej bërë inzheksioni... (S. Çomora, *Inzheksione*, 28); Dhe vërtet, Petrushu kish humbur kësisoj në përleshje *rrumbullak* tre. (Gj. Zheji, *Tregimet* 148); pjesëzat *pikërisht*, *tamam*, *bash*, të cilat vihen para fjalëve a togfjalëshve që zakonisht shërbejnë në fjali si kryefjalë a kundrinë dhe si plotës vendi, krahasimi a

kohe, p.sh. Halimi — *Pikërisht* kjo nuk më pëlqen (F. Paçrami, Tri, 22), — *Pikërisht* gjatë koncertit shoqja Gjeraqinë — sqaroi Muhamedi. (Q. Buxheli, Kur qesh, 106), Leka — Mirëmëngjezi! Agroni qënka pregatitur *tamam* për rrugë (I. Uruçi, Studentja, 59), *Po bash* në këtë Tiranë jetonte ai popull që shkrojti një kapitull të tërë në historinë tonë të lavdishme. (M. Shehu, Lufta, 10).

Pjesëza *pikërisht* pranë përemrave pyetës dhe ndajfoljeve përdoret për të kërkuar një saktësim më të plotë. P.sh. *Ku pikërisht? Kush pikërisht? Çfarë (Cilin) pikërisht?*

Në grupin e pjesëzave përcaktuese-saktësuese hyjnë edhe pjesëzat *po, porsa, sa, sapo, që, qysh, deri (gjer)*, të cilat përcaktojnë a saktësojnë më mirë karakterin e rrjedhjes së një veprimi a procesi të shprehur nga folja.

Pjesëza *po* u paravihet foljeve në kohën e tanishme dhe në kohën e pakryer të mënyrës dëftore e nganjëherë edhe të mënyrës habitore për të shprehur veprime konkrete e të caktuara që vërtetohen në çastin kur flasim a shkruajmë. P.sh. *Shkrep në shkrep* Dajtit bujar *po* na vjen një gjeraqinë; (K. Jakova, Flladi, 5), *Po mbusheshin* dy vjet që Demir Pisha s'kishte bërë një rrugë kaq të largët. (A. Abdihoxha, Ëndra, 33). *Po kush turmën po e çaka?*, (L. Qafëzezi, Proletarët, 109).

Pjesëzat *porsa (posa), sapo* u paravihen foljeve, zakonisht në një nga kohët e së shkuarës të mënyrës dëftore (veç të pakryerës), për të vënë në dukje se veprimi i shprehur nga folja ka marrë fund pak kohë para çastit që merret si bazë për marrëdhënje kohore, ose para një çasti të dhënë të kohës së shkuar. P.sh. *Dukej sikur porsa* kishte dalë nga lumi (F. Gjata, Brezat, 148), — *Xhoda sa* u kthye — tha Mak Mokra. (D. Agolli, Komisari, 226), — *Partia sapo* qe krijuar, *po* çetat e saj shpartallonin batalione me milicë. (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, II, 77).

Pjesëzat *që, qysh* dhe *deri a gjer* u paravihen fjalëve a togfjalëshve, që në fjali shërbejnë si plotës kohe ose plotës vendi. Pjesëzat *që, qysh* shërbejnë për të saktësuar pikënisjen e veprimit në kohë ose në hapësirë, ndërsa pjesëza *deri a gjer* shërben për të saktësuar kohën kur mbaron a cakun ku merr fund veprimi i shprehur nga folja. P.sh. *Këtë partia jonë e kish të qartë qysh* në fillim, prandaj në këtë çështje veptoi drejt. (E. Hoxha, Fjala me inteligjencien, 6), *Thellë nga shpirti, që nga fundi, më pushton një mall'i lehtë.* (V. Bala Poezia, 30), *Jose mbloodhi veten, pa mirë Martën që nga këmba gjer* te koka dhe me çudi kuptoi diçka që *gjer* atë çast as që e kish vënë re. (P. Marko, Hasta, 175), Halimi — ... *Deri* tani s'ka asnjë lajm. (F. Paçrami, Tri, 47).

Pjesëza *që* përdoret edhe para numërorëve themelorë a përemrave të pakufishëm *gjithë* dhe *tërë*, të paraprirë nga nyja e përparme *të*, për të përforcuar edhe më shumë kuptimin përmbledhës, idenë e një tërësie të përcaktuar që shprehet prej tyre. P.sh. *U puthëm buzë më buzë që të tre.* (A. Çaçi, Legjendë, 4), *Masat janë marrë që të gjitha.* (Sh. Musaraj, Para, I, 233), *Të quhi vërtet, bijt' e Skënderbeut që të tërë!* (Asdren, Ëndra, 25).

3. *Pjesëzat përforcuese.* Këto pjesëza shërbejnë për të përforcuar a theksuar më shumë kuptimin e një fjale, të një togfjalëshi a të një fjalie. Në këtë grup hyjnë pjesëzat *vetëm, veç, veçse, sidomos, veçanërisht, edhe, dhe, madje, bile* etj. Këto pjesëza zakonisht shprehin edhe ndonjë nuancë tjetër, prandaj ndahen në: pjesëza përforcuese — veçuese a kufizuese, pjesëza përforcuese — shtuese dhe pjesëza përforcuese — thirrëse.

Pjesëza përforcuese — *veçuese a kufizuese* janë pjesëzat *vetëm, veç, veçse, sidomos, veçanërisht* etj. Këto pjesëza mund të shërbejnë jo vetëm për të përforcuar, por edhe për të veçuar a kufizuar kuptimin e fjalës, të togfjalëshit a të fjalisë së cilës i përkasin. P.sh. *Vetëm* ca taverna kish shikuar dhe ca njerëz ndër trapeza ndarë. (D. Siliqi, Këngë, 36), Mbi ty tek tuk *veç* ndonjë varr ushtari si kaktus i çuditshëm i kohës sonë ka mbirë toka kufitare (I. Kadare, Përse, 76), Nuk kishin kaluar *veçse* pak ditë që ishte ndarë nga ai dhe nuk pandehte kurrë ta takonte kaq shpejt. (V. Kokona, Me valët, II, 59). Dhe vërtet shumë fshatarë, *sidomos* pleq, e quajtën stacionin «Stacioni i teqesë»,... (I. Kadare, Dasma, 8), Armikut nuk i zihet besë, nuk i zihet besë imperializmit, *veçanërisht* imperializmit amerikan. (E. Hoxha, Raport, Raport në Kongr. V, 20).

Pjesëza *vetëm* mund të përdoret e përsëritur. Kjo ndodh kur duhet theksuar akoma më shumë kuptimi i fjalës, i togfjalëshit a i fjalisë të cilave u përket. Shpesh kjo pjesëz shoqërohet me lidhëzat që dhe se, me të cilat formon shprehje që kanë vlerën e një pjesëze. P.sh. Përmbys dheun *vetëm e vetëm* që t'ja shkullë fjalën nga goja. (M. Kuteli, Xinxifilua, 204), «*Ai vetëm* që jep sinjalin për kryengritje, por nuk e bën kryengritjen». (J. Xoxa, Lumi, II, 74).

Në këtë grup hyn edhe pjesëza kufizuese *sa*, e cila përdoret me emra, përemra a numërorë themelorë të privë nga parafjala *për*, si dhe me shprehje ndajfoljore të formuara po me këtë parafjalë. P.sh. *Sa* për dritë, dritë kemi mjaft. (Sh. Musaraj, Para, II, 69), ... pa *sa* për mua mos u sëkëlldisni, kush e nis vallen, di ta dredhë vetë! (A. Varfi, Një histori, 7), Këtu ma verë, afër, t'i rri. Të pi, të dehem *sa* për gjashtë. (Asdren, Endra, 228), Kaq *sa* për sonte. Po vete ora dy. (Sh. Musaraj, Para, I. 343). Kjo pjesëz përdoret edhe me folje, sidomos me paskajoren e tipit për të punuar në funksion qëllimor, caktuesor dhe kallëzuesor. Shpesh mund t'i prijë pjesëza *vetëm*. P.sh. Në heshtjen që ra pas fjalës së Afizit, ajo u koll pak *sa* për të dhënë të kuptohej se ish aty. (Sh. Musaraj, Para, II, 186), I duhet dhënë fund prodhimit *sa* për të prodhuar, me qëllim që të realizohet vëllimi global. (E. Hoxha, Fjalim, 16), Nuk ka asnjë kuptim të mësuarit e teorisë marksiste-leniniste, në bangot e shkollës apo jashtë shkollës, *vetëm sa* për të shkuar radhën. (M. Shehu, Mbi revolucionarizimin, 15).

Pjesëza përforcuese — *shtuese* janë pjesëzat *dhe, edhe, bile e madje*, të cilat krahas përforcimit shprehin edhe nuancë shtuese. P.sh. — Edhe këtu nuk hoqi dorë nga dasmat ky? (Q. Buxheli, Kur qesh, 108), Kur s'patën plumba, shtinë *dhe* me gurë! (D. Agolli, Mesditë, 105) *Madje*, ai qysh tani na e ka frikën, prandaj ka vënë koshadhet... (N. Prifti, Çezma, 13), — Ta merr mendja që ke ndryshuar, shumë *bile*. (Sh. Musaraj, Isha unë, 35), *Bile*, fanatizmi është trashëgim nga ideologjia feudale. (N. Jor-gaqi, Qemal Stafa, 366).

Pjesëza *bile* mund të përdoret e përsëritur. Kjo ndodh kur duhet theksuar akoma më shumë kuptimi i fjalës, i togfjalëshit a i fjalisë të cilave u përket. P.sh. *Bile-bile*, do ish mirë... — Që të mos e hapte gojën fare. (Sh. Musaraj, Para, I, 490).

Në pjesëzat përforcuese-shtuese hyn edhe pjesëza *as*, e cila përdoret në fjali mohuese, para çdo pjese të ligjëratës. P.sh. — Atëherë *as* ti nuk do të shkosh. (B. Levonja, Ditari, 113), Po ti *as* duhanin s'ke kohë të na dredhësh. (A. Shehu, Vite, 11).

Pjesëza përforcuese — *thirrëse* janë pasthirmat *o, oj, or, ore, ori*,

moj, more, mori kur shoqërojnë thirrjet. Në të tilla raste këto fjalë nuk shërbejnë për thirrje, por për të përforcuar thirrjen e shprehur nga thirrori përkatës. Pjesëzat përforcuese-thirrëse lidhen ngushtë nga pikëpamja e shqiptimit me thirrjet, prandaj, ndryshe nga pasthirmat, nuk veçohen me ndonjë shenjë pikësimi. Këto pjesëza mund të shoqërohen me emra-thirrjet frymorë e jofrymorë si dhe me përemrin vetor të vetës së dytë. Pjesëzat përforcuese-thirrëse zakonisht vendosen para thirrjet, por disa mund të vendosen edhe pas tij. Kur janë të prapavendosura shqiptohen të veçara, me përjashtim të pjesës *o*, e cila mund t'i prapangjitet një emri thirrjet në numër njëjës. Pjesëzat *or, ore, mor, more* përdoren me emrat — thirrjet të gjinisë mashkullore, pjesëzat *ori, mori, oj, mori, moj* përdoren me emra — thirrjet të gjinisë femërore, ndërsa pjesëza *o* me emra-thirrjet të gjinisë mashkullore e femërore. P.sh. O Shqipëri, për ty ç'më merr malli (A. Shehu, Vite, 69), — Mbarë paç, o Dyli. (B. Levonja, Ditari, 39), — Or ti, sa ma shet këtë qilim? (M. Kuteli, Xinxifilua, 207), — Ore ti — i tha — do të ikësh tani, apo do të na bësh teatro këtu?! (Q. Buxheli, Kur qesh, 141), Nuk ka talente rrethi ynë, *mor* vëlla dhe mbaroi. (Q. Buxheli, Kur qesh, 156), — *More* Miti, po këtë të ma kishe thënë në krye fare e jo më flisnje për punë. (N. Prifti, Një pushkë, 79), — Ah! *Moj* Tanë, më turpërove në pleqëri, (F. Gjata, Tana, 69), — Evgjeni *moj!* — ju drejtua pastaj së shoqes — dil se të kërkojnë. (Sh. Musaraj, Para, I, 354), — Kështu, shoko, bëni si ju thashë unë. (R. Nepravishta, Pelikanët, 21).

Shënim: o, oj, or, ore, ori, moj, more, mori janë pasthirma kur shërbejnë për të shprehur ndjenja, sidomos thirrje. Me pasthirmat *or, ore, mor, more* u drejtohem frymorëve të seksit mashkull, me pasthirmat *oj, moj, ori, mori*, u drejtohem frymorëve të seksit femër, ndërsa pasthirma *o* përdoret pavarësisht nga seksi i frymorit përkatës. Ato veçohen nga fjalët e tjera të fjalisë me presë, ndërsa kur shqiptohen me fuqi të veçantë pas tyre përdoret pikëçuditësja. P.sh. — Ngadale *o*, se na shurdhove! — tha Guri. (A. Kristo, Shkëndijat, 36), — Or, po ky qënka qorr?! (F. Gjata, Tana, 52), — *Moj*, ti?... — i tha së bijës. — Atë fotografi aty e ka vënë me dorën e vet yt atë. (F. Arapi, Patat, 29), — *More*, mos ka ndonjë rrezik kjo punë? (A. Kristo, Shkëndijat, 107) etj.

4. *Pjesëzat përforcuese*. Në këtë grup hyjnë pjesëzat *afro, aty-aty, nja, si nja, gati, rreth, thua jse (pothua jse), desh, mend* etj. Përdoren para fjalës a togfjalëshit përkatës për ta paraqitur kuptimin e tyre të përforcuar e jo me saktësi.

Pjesëzat *afro, aty-aty, nja, si nja, gati, rreth, thua jse (pothua jse)* përdoren para numërorëve themelorë. Shërbejnë për ta paraqitur të përforcuar, jo me saktësi, zakonisht diçka më të vogël sasinë e sendeve që tregon numërori themelor. Ndenji aty *afro* një orë. (R. Nepravishta, Fusha, 20), *Nja* njëzet kokë dele, që i kishin shpëtuar përmbytjes, blëgërinin e kërkonin shoqet majë pullazit (J. Xoxe, Lumi, II, 107), ... një plak *si nja* gjashtëdhjet vjeç, nuk i kishte hequr akoma dhëntë nga fshati... (Z. Sako, Nga jeta, 18), Para çlirimit në vendin tonë numëroreshin rreth 380 kuadro me arësim të lartë, *rreth* 1600 mësues dhe një numur shumë i kufizuar teknikësh të mesmë etj. (E. Hoxha, Fjala me inteligjencien, 7). Që prej asaj nate që kish arritur aty, në manastirin e Shën Kollit, kishin kaluar *thua jse* dy muaj. (Gj. Zheji, Muret, 30). Dhe m'u kujtua një natë e tillë *gati* tre vjet të shkuara ... (I. Kadare, Gjenerali, 72). Pjesëzat *thua jse (pothua jse)* dhe *gati* përdoren jo vetëm para

numërorëve themelorë, por edhe para fjalësh të kategorive të tjera leksiko-gramatikore. P.sh. Partizanët duhej të shkonin *thua* bashkazi, pesë metro larg njeri tjetrit. (Dh. Shuteriqi, Rruga, 64). Nga rruga nuk dukej *pothua* fare (V. Vinçani, Lumturia 137), *Gati* të gjithëve ju pashë në shfaqjen e fundit. (A. Mara, Brumi, 138). Kur u afrua, nga fytyra m'u duk *gati* fëmijë... (Gj. Zheji, Tregime, 18).

Pjesëza *gati* mund të përsëritet. Në këtë rast nuanca plotësuese e përfaqësisë që ajo i jep fjalës a togfjalëshit përkatës, përforcohet. P.sh. ... qysh nga tetë e deri më dymbëdhjetë vjet, *gati-gati* nuk mbaj mend fare. (H. Stërmilli, Sikur, 33); Asgjë s'do ta kish nevrkosur më tepër Xhezmiun se kjo fjalë e lëshuar *gati-gati* kot. (N. Prifti, Një pushkë, 111).

Pjesëzat *desh* dhe *mend* përdoren vetëm para foljeve-kallëzues me kuptimin *gati*, për pak për të treguar një veprim që vërtet nuk është kryer, por që edhe për pak mund të kryhej. P.sh. M'u muar mëndë dhe *desh* rashë, po e mbajta vehten. (F. Gjata, Zemër, 10), Kur mori vesh nëna, Mënzyrën q'i ngjau, *Desh* lojti nga mendja, Me kuje e qau. (A. Kristo, Fabula, 47). *Mend* e muarën vajzën në qafë xhahilët. (E. Kadare, Një lindje, 194), Ta dha, ta dha, po e pe ç'desh të bënte, *mënd* më mbyti, (V. Vinçani, Të rinjtë, 57).

Para foljeve në mënyrën dëftore, shoqëruar nga pjesëzat e mohimit *s'* a *nuk*, edhe pjesëza *sa* përdoret me kuptimin e pjesëzave përfaqëse *desh* dhe *mend*. Në të tilla raste pjesëzës *sa* mund t'i prijë pjesëza *gati*. P.sh. Kur mbeti vetëm, ai *sa* s'fluturoi nga gëzimi. (Th. Noti, Në gjirin, 38), — Zefi *sa* nuk kish shkalluar nga mëndt. (Sh. Musaraj, Para, I, 339), Në rrugën e vogël ai pa shokun që *gati sa* nuk vraponte. (Drita, 15, 9, 68), Aha, pasnesër është festa e tyre kombëtare, *gati sa* s'më doli nga mëndja... (I. Kadare, Gjenerali, 136).

II. Pjesëzat modale

Këto pjesëza shërbejnë për të shprehur qëndrimin e folësit ndaj një a më shumë mendimeve të shprehura, ndaj vërtetësisë së një ngjarjeje a dukurie të realitetit objektiv. Në këtë grup hyjnë pjesëzat: 1) pohuese, 2) mohuese, 3) pyetëse, 4) dyshuese dhe 5) zbutëse.

1. *Pjesëzat pohuese*. Në pjesëzat pohuese hyjnë *po*, *posi*, *po që po*, *po se po*, *si urdhëron* etj. Që të gjitha mund të përdoren edhe të veçuara, me vlerën e një fjalie, sidomos pjesëzat *po* dhe *posi*.

Pjesëza *po* ka përdorim më të gjerë dhe paraqitet me më shumë nuanca kuptimore. Ajo shërben për të pohuar a miratuar një mendim, për të lejuar një veprim ose për të dhënë mendimin për diçka. P.sh. — Me gjith mend e ke? — *Po*. (F. Gjata, Brezat, 108), — Mos të arrestuan gjë? — pyeti një nga shokët. — *Po*, më arrestuan, — ja priti Qemali buzagaz, duke hyrë brenda në vendin e mbledhjes. (N. Jorgaqi, Qemal Stafa, 370).

Pjesëza *po* përdoret edhe kur folësi pa prituri kujtohet për diçka që e ka harruar. P.sh. Halimi — A, *po*, harrova ndryshojnë kohët... (F. Paçrami, Tri, 19), Tjetri, ah, *po*, tjetri është gjeolog dhe flet për... (A. Abdihojha, Endra, 226).

Kur duam të forcojmë pohimin, pjesëza *po* përsëritet ose shoqërohet me fjalë që kanë kuptim modal (sigurisht, natyrisht etj.). P.sh. Afërdita — është Alqi! *Po*, *po*, ai është! (I. Uruçi, Studentja, 12), Bardha — Të

martohesh me Yllin, *po, po*, të martohesh, medoemos të martohesh. (F. Paçrami, Tri, 37).

Pohimi shprehet i përforcuar edhe me pjesëzën *posi* dhe me lokucionet *po që po, po se po*. Këto përdoren sidomos kur folësi pohon diçka që vihet në dyshim. P.sh. — Po ti më do? — *Posi* (S. Andoni, Tregime, 133), — Sigurisht! — ju përgjigj Cuçi — Po ju? — Ne *po e po...* Ju çfarë vendi zutë? (Q. Buxheli, Kur qesh, 133), Djemtë *po se po*, por edhe shumica e pleqve vendosën të mos punonim asnjë ditë angari për beun. (S. Spasse, Ata, 258).

Pjesëza *si urdhëron* (*si urdhëroni*) përdoret për të shprehur pëlqimin e plotë të folësit, gatishmërinë a bindjen e tij për atë që thuhet. P.sh. — Ti e ke bërë këtë? — *Si urdhëron!* (F. Gjata, Brezat, 98), — *Si urdhëroni*, zonzjë! — ja nise ti me gjakftohtësinë më të madhe. (B. Lëvonja, Ditari, 286).

Në disa raste, në përshtatje me kontekstin, të gjitha pjesëzat pohuese, sidomos pjesëzat *po, posi, si urdhëron*, e gërshetojnë kuptimin pohues dhe me ndonjë nuancë emocionale (mosbesim, habi, kundërshtim, ironi, përbuzje etj.). P.sh... nga që nuk dinte ç'të bënte tjetër, shfrynte: — *Pooo... Poooo...* do t'i mburret nuses ai! (M. Zaloshnja, Zëra, 41); — I mirë *posi*, për të pirë në kupën e hudhrave (S. Andoni, Kandili, 45); Që ta merrje nuse për mua? *Posi!* Ti të gjitha vajzat e Korçës kërkon t'i marrësh nuse për mua (V. Kokona, Me valët, II, 61).

SHËNIM:

Disa pjesëza pohuese si *e, ëhë*, etj., përdoren zakonisht në gjuhën e folur. P.sh. Nesër thuaj! — *E*, nesër! — bëri me dorë Arifi (D. Agolli, Komisari, 242), — Të pëlqen? — *Ëhë...* (F. Arapi, Patat, 47)..

2. *Pjesëzat mohuese*. Pjesëza mohuese janë: *jo, nuk, s', mos, jo që jo, jo se jo, as që* etj.

Pjesëza *jo* shërben për t'i dhënë përgjigje mohuese mendimit a mendimeve të shprehura nga një tjetër ose nga vetë folësi, për të kundërshtuar a për të mos lejuar diçka. P.sh. — Ju jap dhjetë robër. — *Jo*. — Ju jap më shumë. Ju jap tankistët krejt. — *Jo*. (I. Kadare, Gjenerali, 165), A i ke thënë njeriu se do të vije këtu? — *Jo...* nuk i kam thënë njeriu... (N. Jorgaqi, Posta, 48), Genci — Në fund të fundit ç'ke me mua? Të foli njeri ty? *Jo*. (F. Paçrami, Tri, 34).

Shpesh pjesëza *jo* përdoret në vend të një folje — kallëzues me pjesëz mohuese a në vend të një fjalisë mohuese. P.sh. Burokratët kanë frikë nga masat; revolucionarët *jo*. (E. Hoxha, Revolucionarizimi, 36), Prindërit tuaj jemi, apo *jo*? (F. Arapi, Patat, 72).

Pjesëzat mohuese *nuk* dhe *s'*, që janë sinonime për nga kuptimi dhe përdorimi, shërbejnë për të mohuar plotësisht veprimin a gjendjen e shprehur nga folja, duke i dhënë kështu gjithë fjalisë kuptim mohues. Që të dyja vihen para formave gramatikore të mënyrave dëftore, kushtore a habitore. P.sh. — *Nuk* ju lejoj, — ja priti i xhindosur protektori. (N. Jorgaqi, Qemal Stafa, 290), — Do të mësohesh. — *S'besoj*, — tha ajo. (F. Arapi, Patat, 76), Më kishe dhënë fjalën se nuk do të dilje, por ja, nuk e mbajte (F. Paçrami, Dy, 38), Or po të thonë që po e nisin në Itali, ti *s'merrke* vesh! — ja priti plaku që rrinte paraELIT. (Gj. Zheji, Ngjarje, 71).

Pjesëza *mos* përdoret para formave gramatikore të foljeve në mënyrat dëshirore e urdhërore. Përdoret gjithashtu pas pjesëzave përkatëse

të foljeve në format gramatikore të mënyrës lidhore dhe në format e pashtjella të përcjellores a të paskajores së formuar me pjesëzën para-fjalore *për*. Kjo pjesëz shërben për të kundërshtuar a mohuar plotësisht veprimin a gjendjen e shprehur nga folja. P.sh. Atëhere do të binte mbi trupin e tij, do ta pushtonte dhe do të qante me ngashërim, gjersa të *mos* kishte më lotë. (N. Prifti, Një pushkë, 24); Ç'nuk kishim bërë për të *mos* e marrë, po ku dëgjonte ay! (A. Mara, Shtëpia, 19).

Kjo pjesëz mund të përdoret edhe e mvetësishme, me vlerën e një fjalie. Në këtë rast kuptimi mohues gërshetohet me ndonjë nuancë të theksuar emocionale (dëshpërim, habi, kundërshtim, ironi, etj.). P.sh. — Është vrarë Kajua! — *Mos!* ... (B. Lëvonja, Ditari, 305), Bardha — *Mos*. S'është e mundur! (F. Paçrami, Tri, 35).

Për të përforcuar mohimin, pjesëzat mohuese *jo* dhe *mos* mund të përsëriten, ndërsa pjesëzat *nuk*, *s'* dhe *jo* mund të shoqërohen me fjalë që kanë kuptim mohues ose modal. Në të tilla raste kuptimi mohues i pjesëzave *jo* dhe *mos* gërshetohet zakonisht edhe me ndonjë nuancë emocionale si habi, kundërshtim, dëshpërim, lutje etj. P.sh. Gruaja: *Jo! Jo!* Më mirë t'ju them, se sa të më turpërosh! (S. Çomora, Nga fshati, 24), Feridi: (I bie ballit me shuplakë). *Mos, mos-* (F. Kraja, Fisheku, 20), Unë tokën si njerë kurrë *s'*e kam parë, po e kam parë si nënë. (D. Agolli, Mesditë, 86). Afrohuni, shokë, pa frikë dhe kini për të parë se asgjë *nuk* do të ndodhë. (N. Jorgaqi, Qemal Stafa, 336). A do ta lëmë të vazhdojë në këtë rrugë? Sigurisht *jo*. (Pionieri, 21, 2, 1968).

Edhe shprehjet me vlerën e një pjesëze *jo që jo, jo se jo, as që* etj. përdoren sidomos kur folësi mohon diçka që vihet në dyshim. P.sh. Unë *jo që jo*, por edhe babai im *s'*ka vënë dorë kurrë në ta. (B. Lëvonja, Ditari, 140), Kjo *nuk* është një punë e thjeshtë, shokë, dhe *as që* mund të kryhet nga një ose dy persona... (E. Hoxha, Mbi kuptimin, 32).

Në disa ndërtime të gjuhës shqipe dy pjesëza mohuese përdoren për të dhënë një mendim pohues. Kjo ndodh, kur njëra pjesëz (*nuk* ose *s'*) vendoset para foljes zakonisht modale a pavetore, ndërsa pjesëza tjetër (*mos*) vendoset para një folejeje në mënyrën lidhore. P.sh. S'është e mundur që tërë ky rreth të *mos* ketë qoftë edhe një talent të vetëm! (Q. Buxheli, Kur qesh, 157), ... të *mos* mendojmë se *nuk* kemi të meta dhe gabime. (E. Hoxha, Mbi kuptimin, 13).

Pjesëzat mohuese i japin kuptimit të përgjithshëm të fjalisë nuancë pohuese, zakonisht të gërshetuar me ndonjë nuancë emocionale — shprehëse edhe në disa raste të tjera. P.sh. *Nuk* dalim pakëz në ballkon se m'u mërzi kjo dhomë e murmë... (M. Xhaxhiu, Rapsodi, 11), Kush *nuk* e kujton çastin e lumtur kur e ka thirrur... (R. Brahimi, Zgjim, 92), Ku *nuk* ka ndërhyrë? (M. Zaloshnja, Zëra, 61), E çfarë *s'*bëra unë për këta fëmijë?! (F. Paçrami, Tri, 26), Pas këtyre fjalëve që i shqiptoi *jo* pa dhimbje, ai heshti, bëri një pauzë të gjatë (N. Jorgaqi, Dashuria, 139), — Si *jo* — u përgjegj. Në mënyrë shkencore, bile. (Q. Buxheli, Kur qesh), ... Pse të *mos* vija?— (A. Mara, Brumi, 112).

3. *Pjesëzat pyetëse*. — Në këtë grup hyjnë pjesëzat *a, ë, e*, të cilat shërbejnë për të pyetur. Kuptimi pyetës i këtyre pjesëzave gërshetohet zakonisht edhe me nuanca kuptimore të tjera, sidomos emocionale.

Pjesëza pyetëse *a* përdoret sidomos në fillim të një fjalie pyetëse. Në këtë rast ajo shërben zakonisht për të nënvizuar a theksuar më shumë natyrën pyetëse të kësaj fjalie. P.sh. Po ne ç'jemi këtu? A s'jemi edhe ne të bukura? (M. Kuteli, Xinxifilua, 166), — A *mos* ke mbetur pa bukë? (F. Arapi, Patat, 35).

Kjo pjesëz pyetëse përdoret edhe në fjali pyetëse retorike, me të cilat më shumë shprehet një pohim emocional se sa një pyetje. P.sh. A mund të përvetësohen dituria, mendimi krijues i njerëzve dhe eksperiencia e më të mirëve që na rekomandon vazhdimisht partia pa vënë në rrugë të drejtë çështjen e organizimit të këtyre problemeve? (E. Hoxha, Mbi kuptimin, 16), «A ka fjalë më të rëndë për shqiptarin se sa t'i thuash se e ka shkelur besën? (M. Kuteli, Tregime, 30).

Pjesëzat pyetëse *a* dhe *ë* përdoren në fund të një fjalie, me anën e së cilës kërkohet përgjigje, pohim etj. Veçanërisht në këtë rast pjesëzat pyetëse *a* dhe *ë* shprehin, krahas kuptimit pyetës, edhe ndonjë nuancë të theksuar emocionale si përbuzje, ironi, qortim etj. P.sh. Kështu janë të rinjtë *a*? (Sh. Musaraj, Para, II, 112), — Po si thua ti, si del paraja, këput fiq dhe ha, *ë*? (T. Laço, Rruga, 139),... S'të erdhi mirë, *ë*? (F. Paçrami, Dy, 24).

Shpesh këto pjesëza përdoren të mvetësishme për të kërkuar përsëritjen e një pyetjeje *a* të një mendimi që nuk është dëgjuar nga folësi. P.sh — *A?* — ja bëri poetieri, që ju bë se ajo diçka pëshpëriti. — Fol më fort, se më kanë lënë veshët. (E. Kadare, Një lindje 164), — Kot pyes. Më tërhoqi vemendjen fizionomia e tij — tha Memua. — *Ë?* — Fizionomia! (D. Agolli, Komisari, 169).

Pjesëza pyetëse *e* përdoret gjerësisht sidomos e veçuar. P.sh. — *E?* pyeti përsëri ai me padurim. — Vajte? (E. Kadare, Një lindje, 226), — *E?* — pyeti Memua. — Më grisi kërcën e veshit i poshtri — tha Nurka me dorë në vesh. (D. Agolli, Komisari, 277).

Për të pyetur, përdoren edhe pjesëza të grupeve të tjera, ndërmjet të cilave pjesëza pohuese *po* dhe pjesëza mohuese *jo*. Zakonisht kur kërkohet a pritët përgjigje pohuese, përdoret pjesëza *po*, ndërsa për përgjigje mohuese pjesëza *jo*. P.sh. — *Po?* — pyeti përsëri ajo, kur pa që Bardha largonte kokën dhe refuzonte t'i përgjigjej. (E. Kadare, Një lindje, 112), Genci — *A* të paguajnë gjë për orët suplementare? (Nuk merr përgjigje) *Jo?! (F. Paçrami, Tri, 13).*

4. *Pjesëzat dyshuese.* Në pjesëzat dyshuese hyjnë: *ndofta (ndoshta), mbase, kushedi, sikur, vallë, gjë, etj.* Përdoren për t'i dhënë fjalës, togfjalëshit a fjalisë nuancë dyshimi, mosbesimi, pasigurie etj. Pjesëzat *vallë* dhe *gjë* përdoren vetëm në fjali pyetëse, ndërsa pjesëzat sinonime *ndofta, mbase, kushedi* dhe pjesëza *sikur* përdoren edhe në fjali jopyetëse. P.sh. «Përse më thirrën *vallë?* — mendonte Malaj, — apo përsëri për atë punën e vjetme?», (T. Laço, Rruga, 90), E patë gjë shokun Fejzo? — pyeste ai karpentieri, që kish qenë në stacion, duke çarë midis njerëzve. (I. Kadare, Dasma, 195) — *Ndoshta* dheu u rrëzua vetë? (I. Kadare, Kështjella, 120), Planet ishin *ndofta* shumë të thjeshta, po ishin plane. (P. Marko, Stina, 83), — *Mbase* unë ekzaltohem, *mbase* unë e tepëroj, por para këtyre njerëzve mahnitem. (D. Agolli, Komisari, 85), — *Kushedi* — mendoi, — mund të ketë gjetur ndonjë tjetër. (R. Brahimi, Zgjim, 67), — Ty *sikur* të shoh pak si të çuditur. Më duket se do të më pyesësh gjësend. (M. Kuteli, Netë, 102), Bakiu *sikur* nuk u kënaq. (R. Nepravishita, Fusha, 164).

Pjesëzat dyshuese *ndofta, mbase, kushedi* mund të përdoren edhe të mvetësishme, me vlerën e një fjalie. P.sh. — U ndeshët me Skënderbeun? — pyeti jeniçeri. — *Ndoshta.* (I. Kadare, Kështjella, 104), — Mos janë vëllezër? — *Kushedi...* (F. Arapi, Patat, 53), — S'e mbaj mend. — E mbaj unë. — *Mbase.* (V. Kokona, Me valët, 195).

Edhe pjesëza mohuese *mos* mund të përdoret me kuptimin e një pje-

sëze dyshimi. P.sh. *Mos do të thuash që i fsheh unë? ngriti zërin Hajdari (F. Gjata, Brezat, 17), — Mos është i fortë? (M. Zaloshnja, Zëra, 57).*

Nuanca e dyshimit shprehet e përforcuar kur pjesëza *mos* shoqërohet me ndonjerën nga pjesëzat *ndoshta, vallë, kushedi, gjë*. P.sh. Halimi — Pak përpara u ankove se nuk kam dashur të di për asgjë, *mos ndoshta tani po ndërhy shumë?* (F. Paçrami, Tri, 24), ... të pritnin si guaskë se *mos kushedi* gjendej ndonjë peshk budalla. (Gj. Zheji, Tregimet, 96), *Mos vallë* ja rrëmbeu zemrën Skënderi? (D. Shaplo, Përtëritje, 112), Kishte frikë se mos qe *gjë* sëmurë, por më tepër e hante merakun se mos i kish ndodhur ndonjë e papritur... (N. Jorgaqi, Dashuria, 195).

Pjesëza *mos*, duke u bashkuar me lidhëzën ffilluese se formon shprehjen *se mos*, me vlerën e një pjesëze. Përdoret për të shprehur jo vetëm dyshim, por edhe ndonjë nuancë emocionale (ironi, përbuzje, nënvleftësim, kundërshtim etj.). P.sh. — Shiko, shiko. Na marrshin të keqen! *Se mos* ne i duam. Plasëm për ta. (A. Abdihoxa, Tri ngjyrat, II, 244), Leonora — *Se mos* e dimë se ku e ka hallin ajo? (I. Uruçi, Studentja, 30), ... ai kështu e ka: ndryshe flet në sy, ndryshe prapa krahëve. *Se mos* nuk e njih (S. Spasse, Afërdita, 48).

5. *Pjesëzat zbutëse*. Këto pjesëza shërbejnë për ta zbutur pak a shumë kuptimin e fjalës së cilës i përkasin. Në këtë grup hyjnë pjesëzat *pa, as, le, para, dot* etj.

Pjesëzat *pa* dhe *as* vihen para foljeve, në vetën e dytë, njëjës ose shumës, të mënyrës urdhërore për ta paraqitur urdhërin zakonisht në formë dëshire, nxitjeje e lutjeje. P.sh. — Zemër, *pa* më thuaj, emërin si e kanë, se për kokën tënde seç po vinj vërdallë! (A. Çaçi, Këngët, 28), — *Pa* shih dhe ti një herë, Agim! (Dh. Shuteriqi, Pesë tregime, 11), «*As* na këndo, ti o vashë, një këngë me zë të trashë» (K. Kristoforidhi, Gjahu, 16).

Pjesëza *le* vihet para foljeve në vetën e tretë, njëjës ose shumës dhe në vetën e parë shumës të kohës së tashme të mënyrës lidhore, kur kjo përdoret me kuptimin e mënyrës urdhërore. Por kjo pjesëz përdoret edhe në kohët e tjera të mënyrës lidhore, pavarësisht nga veta e numri. Shërben zakonisht për ta paraqitur urdhërin e veprimin e shprehur nga folja në formë nxitjeje, lejimi a pëlqimi. P.sh. ... *Le* të shkojnë edhe fëmijët e tu, se kjo rrugë për ta po ndërtohet. (K. Jakova, Dom Gjoni, 64), Nëqoftëse ai kaq fort do që të vijë, Në këtë botë, ahëre *le* të vijë. (I. Kadare, Shekulli im, 47), Më mirë *le* të kalbesh unë në burg se sa të burgosej gjithë Shqipëria. (J. Xoxa, Lumi, II, 191), ... dhe ç'ti gjente *le* t'i gjente me shokët bashkë. (Z. Sako, Njerëz, 50).

Pjesëza *para* përdoret vetëm me pjesëzat mohuese *nuk, s', mos* për ta zbutur mohimin e shprehur prej tyre ose për ta paraqitur atë sporadik. P.sh. Dhoma *s'para* ishte e madhe. (A. Abdihoxa, Tri ngjyrat, I, 228), Nuk *para* del në fshat. (Z. Sako, Nga jeta, 15).

Pjesëza *dot* përdoret në fjali pyetëse, në fjali mohuese ose në fjali kushtore. Në fjali pyetëse ose kushtore kjo pjesëz i jep kuptimit të foljes nuancën e mundësisë, ndërsa në fjali mohuese përdoret për të shprehur pamundësinë e kryerjes së veprimit të treguar nga folja. P.sh. S'të kandidëm *dot*? (S. Andoni, Tregime, 315), Nuk tregohet *dot* me fjalë Zarika ç'ka vuar. (A. Çaçi, Zarika, 32).

III. Pjesëzat emocionale-shprehëse

Pjesëzat emocionale-shprehëse shërbejnë për të nënvizuar anën emocionale të të folurit dhe për të rritur fuqinë shprehëse të tij. Në këtë grup hyjnë pjesëzat *ç'*, *seç*, *de*, *pra*, *pa*, *se* etj.

Pjesëzat *ç'* dhe *seç*, që janë të afërta nga kuptimi dhe përdorimi, vihen zakonisht në fillim të një fjalie dëftore a të një vargu për të theksuar ndjenjën e kënaqësisë, të habitës, të gëzimit, të keqardhjes etj. P.sh. Brenda në Tiranë, mu afër spitalit, Ç'u vra Qemal Stafa, Një trim nga të malit. (Këngë popullore, 345), Lart n'ato miniera trimi seç po shkon. (A. Varfi, Në tingujt, 22). Një ujk i uritur seç na la folenë. (A. Kristo, Fabula, 44).

Pjesëzat *de* dhe *pra* janë gjithashtu të afërta nga kuptimi e përdorimi. Shërbejnë për të rritur fuqinë shprehëse të të folurit, sidomos duke nënvizuar kuptimin e fjalës e të fjalisë përkatëse. Këto përdoren shpesh edhe pranë pjesëzave të tjera, sidomos pas pjesëzave *ja*, *jo*, *po*. P.sh. Ruaj zërin *de*, se do ngjiresht prapë dhe na mori lumi! (Q. Buxheli, Kur qesh, 103), Merre *pra!* (B. Levonja, Ditari, 136), Ja *pra*, këto direktiva nuk i dinë, këta tanët, prandaj bien në gabime, — tha Petro Paskali, (A. Kristo, Shkëndijat, 335).

Pjesëzat *pa* dhe *se* janë sinonime. Përdoren zakonisht në fund të një fjalie pyetëse për të theksuar nuancën emocionale — shprehëse të saj. E si e mori vesh *pa?* (F. Gjata, Tana, 65), Dhe përse *pa*, për një lëkurë ujku... (N. Prifti, Lëkura e ujkut, 11), Sa hije të paska *se?!...* — tha halla... (H. Stërmilli, Sikur, 40), Mirëpo, kush e besonte *se?* (Q. Buxheli, Kali, 45).

Si pjesëza emocionale — shprehëse përdoren edhe shprehjet me vlerën e një pjesëze *e po*, *ja që*, *le që*, *pa le* etj. Shërbejnë për t'i dhënë gjallëri e hijeshi shprehjes së mendimeve. P.sh. — *E po*, të na trashëgohen, o Ramiz! (F. Gjata, Brezat, 4), Vera — *E po*, mjaft qeshët *de!* (F. Paçrami, Tri, 12). Por *ja që* ky është realiteti, megjithëse ky realitet nuk u pëlqen armiqve. (M. Shehu, Mbi revolucionarizimin, 17), — *E mirë është, po ja që* ajo fiket. (M. Kuteli, Xinxifilua, 49), — Gjersa të mbarojë kjo punë... *Le që* s'ka për të mbaruar dot. (Gj. Zheji, Tregimet, 63), — Edhe roje, *pa le!* ç'të duhej roja ty, bre Bim! (Sh. Musaraj, Para, I, 250), *Pa le*, vete dhe shpik sëmundje me lloj-lloj emra! (E. Kadare, Një lindje, 15).

SHËNIM

Të ashtuquajturat pjesëza trajtëformuese ose gramatikore janë një grup mjetesh gramatikore me prejardhje nga pjesë të ndryshme të ligjëratës, të cilat, si kanë humbur veçoritë leksiko-gramatikore përkatëse, janë shdërruar prej kohësh në mjete për formimin e disa trajtave gramatikore të fjalëve. Të tilla janë: *u*, *do*, *të*, *me*, *për*, *pa*, *duke* dhe *më*. Përveç *më*-së të gjitha të tjerat përdoren për të formuar trajta gramatikore të foljeve:

1. *u*, shërben për të formuar disa trajta gramatikore të foljeve në diatezat vetëvetore e pësore (*u* lava, *lahu* etj.);
2. *do* shërben për të formuar trajtat gramatikore të kohës së ardhme dhe të mënyrës kushtore (*do* të lexoj, *do* të punoja);

3. *të* shërben për të formuar trajtat gramatikore të foljeve në mënyrën lidhore dhe lidhore-habitore (*të jem, të paskesha*);

4. *pa* dhe *duke* shërbejnë për të ndërtuar, mbi bazën e pjesores, përkatësisht formën e pashtjellë mohore (*pa* punuar) dhe formën e pashtjellë përcjellore (*duke* punuar).

5. *me* dhe *për* shërbejnë për të formuar, mbi bazën e emrit foljor asnjës, përkatësisht formën e pashtjellë të tipit *me të shkuar* dhe formën e pashtjellë paskajore të tipit *për të shkuar*.

Shënim:

Me *me* formohet, mbi bazën e pjesores, edhe trajta e pashtjellë paskajore e tipit *me shkue*, që përdoret vetëm në gegërishte.

6. *më* shërben për të formuar trajtat e mbiemrave e të ndajfoljeve në shkallë krahasore e sipërore (*më* i shpejtë, *më* lart, *më* i miri etj.).

Me që të gjitha këto tashmë s'janë më fjalë, por pjesë përbërëse të trajtave gramatikore përkatëse, nuk mund të hyjnë në asnjë kategori leksiko-gramatikore.

LITERATURA PËR PJESËZAT

1. Josif Kole: Pjesëzat si kategori leksiko-semantike në shqipen e sotme, Studime filologjike, Nr. 3, 1969.
2. Shaban Demiraj: Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, pjesa II, dispensë, Tiranë, 1966.
3. Mehmet Çeliku: Togfjalësja të qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme, Studime filologjike, Nr. 2, 1962.
Mehmet Çeliku: Thirrori në gjuhën shqipe, kapitull për Gramatikën shkencore të shqipes, 1969.
4. Engjëll Angoni: Pashirrat, Arësimi popullor, Nr. 3, 1962.
5. Akademia nauk SSR: Grammatika russkova jazika (pjesa I), Moskva, 1962.
6. Akademia Republicii romine: Grammatika limbii romine, vol. I, Bukuresht, 1963.
7. Ferdinand Brunot: La pensee et la langue, masson et editeurs, 1953.
8. Gallkina Fjodoruk.: Sovremennij russkij literaturnij jazik, Moskva 1964.
9. Gvozdev A.N. : Sovremennij russkij literaturnij jazik, I, 1961.
10. Jean Clude Chevalier etj.: Grammaire larousse du français contemporaine, Librairie Larouse.
11. Kristalina Çollakova: Çasticitje v sovremennija bëllgarsku knizhoven jezik, Sofia, 1958.
12. L. A. Cesko: Izuçenie slovo ne švjazannie predložheniem.
13. Hermann Paul: Deutsche Grammatik, Band V, Wortbildungslehre, Halle (Saale) 1959.
14. V. V. Vinogradov: Sovremennij russkij jazik, morfologia, Moskva, 1952.
15. V. V. Vinogradov: Russkij jazik, Moskva 1947.

Letërsia artistike e shfrytëzuar dhe citimet e përdorura

- | | |
|-----------|---|
| A. Mara | Brumi, Brumi i zjarhtë, Tiranë, 1969. |
| » | Shtëpia, shtëpia e Xha Milit, Tiranë, 1955. |
| A. Shehu | Vite, Vite pa thinja, Tiranë, 1970. |
| A. Kristo | Fabula, Tiranë, 1955. |
| Asdren: | Endra, Endra e lotë, Bukuresht, 1912. |

- A. Çaçi: Këngët, Këngët e dheut, Tiranë, 1951.
 » » Legjendë, Legjendë e kuqe, Tiranë, 1968.
 » » Zarika, Tiranë, 1955.
- A. Abdihoxha: Ëndra, Ëndra dhe dritë, Tiranë, 1963.
 » » Tri ngjyrat, Tri ngjyrat e kohës, I, II, Tiranë, 1966, 1969.
 » » Një vjeshtë, Një vjeshtë me stuhi, Tiranë, 1959.
- A.Z. Çajupi: Baba-Tomorri, Tiranë, 1950.
- A. Varfi: Në tingujt, Në tingujt e revolucionit, Tiranë, 1951.
 » » Një histori, Një histori e lashtë stërgjyshore, Tiranë, 1957.
- B. Lëvonja: Ditari, Ditari ynë, Tiranë, 1970.
- D. Shaplllo: Përtëritje, Tiranë, 1960.
- D. Siliqi: Këngë, Këngë e re për dashurinë e vjetër, Tiranë, 1960.
- D. Agolli: Mikja, Tiranë, 1958.
 » » Mesditë, Tiranë, 1969.
 » » Komisari, Komisari Memo, Tiranë, 1970.
- Dh. Shuteriqi: Pesë tregime, Tiranë, 1953.
 » » Rruga, Rruga e rinisë, Tiranë, 1953.
 » » Çlirimtarët I, II, Tiranë, 1950-1955.
- Dh. Xhuvani: Kambana, Kambana e fundit, Tiranë, 1959.
- E. Hoxha: Fjala me inteligjencien, Fjala e mbajtur në takimim me përfaqësuesit e inteligjencies së kryeqytetit, Tiranë, 1962.
 » » : Raport në Kong. V, Raport mbi aktivitetin e KQ të PPSH, Tiranë, 1966.
 » » Fjalim, Fjalim i mbajtur në mbledhjen solemne me rastin e 15-vjetorit të çlirimit të atdheut, Tiranë, 1959, 16).
 » » Revolucionarizimi, Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë, Tiranë, 1968.
 » » Mbi kuptimin, Mbi kuptimin teorik e praktik të organizimit të punës, Tiranë, 1970.
- E. Kadare: Një lindje, Një lindje e vështirë, Tiranë, 1970.
- F. Paçrami: Dy, Dy drama, Tiranë, 1963.
 » » Tri, Tri drama, Tiranë, 1968.
- F. Noli: Historia, B-M 1950, Historia e Skënderbeut, Boston-Mass, 1950.
- F. Gjata: Zemër, Zemër shqiptare, Tiranë, 1953.
 » » Tana, Tiranë, 1958.
 » » Në pragun, Në pragun e jetës, Tiranë, 1960.
 » » Brezat, Tiranë, 1968.
- F. Arapi: Ritme, Ritme të hekurta, Tiranë, 1968.
 » » Patat, Patat e egra, Tiranë, 1970.
- F. Kraja: Fisheku, Fisheku në pajë, Tiranë, 1967.
- Gj. Zheji: Tregimet, Tregimet e Krujës, Tiranë, 1967.
 » » Muret, Muret e Krujës, Tiranë, 1968.
- H. Stërmilli: Sikur, Sikur t'isha djalë, Tiranë, 1959.
- I. Kadare: Shekulli im, Tiranë, 1961.
 » » Gjenerali, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, 1963.

- I. Kadare. Përse, Përse mendohen këta male, Tiranë, 1964.
 » » Dasma, Tiranë, 1968.
 » » Qyteti, Qyteti i jugut, Tiranë, 1967.
 » » Kështjella, Tiranë, 1970.
- I. Uruçi: Studentja, Studentja e vitit të fundit, Tiranë, 1970.
- J. Xoxa: Novela, Tiranë, 1958.
 » » Lumi, I, II, Lumi i vdekur, v. I, II, Tiranë, 1965, 1967.
- K. Kristoforidhi: Gjahu, Gjahu i malësorëvet, Tiranë, 1950.
- K. Jakova: Dom Gjoni, Tiranë, 1957.
 » » Halili, Halili e Hajrija, Tiranë, 1950.
 » » Flladi, Flladi i Tetorit, Tiranë, 1956.
- L. Qafëzezi: Proletarët, Tiranë, 1960.
- L. Poradeci: Ylli, ylli i zemrës, Bukuresht, 1937.
 » » Mbledhës, I, II, Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, vol. I, II, Tiranë, 1961.
- M. Shehu: Lufta, Lufta për çlirimin e Tiranës, Tiranë, 1959.
 » » Raport në Kong. IV; Raport mbi direktivat e planit III 5-vjeçar, Tiranë, 1961.
 » » Mbi revolucionarizimin, Mbi revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë, Tiranë, 1968.
- M. Kallamata: Netë, Netë gjahtarësh, Tiranë, 1959.
- M. Kuteli: Xinxifilua, Tiranë, 1962.
 » » Netë, Netë shqiptare, Tiranë, 1944.
- M. Gurakuqi: Miniera, Miniera nuk u mbyll, Tiranë, 1951.
- M. Zaloshnja: Zëra, Zëra të fuqishëm, Tiranë, 1969.
- M. Xhaxhiu: Lirika, Tiranë, 1957.
 » » Rapsodi, Rapsodi Magjare, Tiranë, 1961.
- N. Frashëri: Lulet, Lulet e verës, Tiranë, 1950.
- N. Frashëri: Bagëti, Bagëti e bujqësia, Tiranë, 1964.
- N. Prifti: Lëkura, Lëkura e ujkut, Tiranë, 1958.
 » » Çezma, Çezma e floririt, Tiranë, 1960.
 » » Një pushkë, Një pushkë më shumë, Tiranë, 1966.
- N. Jorgaqi: Dashuria, Dashuria e Mimosës, Tiranë, 1960.
 » » Ëndëra, Ëndëra dhe plagë, Tiranë, 1963.
 » » Posta, Posta e largët, Tiranë, 1968.
 » » Qemal Stafa, Tiranë, 1970.
- N. Bulku: Legjenda, Legjenda e një fisi, Tiranë, 1966.
- P. Marko: Hasta, Hasta la vista, Tiranë, 1958.
 » » Qyteti, Qyteti i fundit, Tiranë, 1960.
 » » Stina, Stina e armëve, Tiranë, 1966.
 » » Halimi, Tiranë, 1969.
- Q. Buxheli: Kali, Kali i mbretit dhe kalorës të rinj, Tiranë, 1960.
 » » Kur, Kur qesh gjithë qyteti, Tiranë, 1970.
- R. Brahimi: Zgjim, Zgjim pranvere, Tiranë, 1969.
- R. Nepravishta: Fusha, Fusha po zgjohet, Tiranë, 1955.
- S. Andoni: Kandili, Kandili i shuar, Tiranë, 1964.
- S. Çomora: Inzheksione, Inzheksione që duhen bërë, Tiranë, 1961.
 » » Nga fshati, Nga fshati i gruas, Tiranë, 1957.
 » » Drama, Tiranë, 1964.
- S. Spasse: Ata, Ata nuk ishin vetëm, Tiranë, 1952.
 » » Afërdita, Afërdita përsëri në fshat, Tiranë, 1956.
 » » Buzë, Buzë liqenit, Tiranë, 1965.
- S. Pitarka: Trimi, Trimi i mirë me shokë shumë, Tiranë, 1958.

Sh. Musaraj	Isha, Isha unë Çobo Rrapushi, Tiranë, 1960.
» »	Para, I, II, Para agimit, vol. I, II, Tiranë, 1965, 1966.
T. Laço:	Rruga, Rruga e bardhë, Tiranë, 1967.
V. Kokona:	Me valët, I, II, Me valët e jetës, vol. I, II, Tiranë, 1961, 1965.
» »	Hijet, Hijet e natës, Tiranë, 1966.
V. Vinçani:	Lumturia, Tiranë, 1965.
» »	Të rinjtë, Tiranë, 1958.
V. Skënderi:	Vjershat, Vjershat dhe poemat e Drinit, Tiranë, 1967.
V. Bala:	Poezia, Poezia e rrugës, Tiranë, 1959.
Z. Sako:	Nga jeta, Nga jeta në luftë, Tiranë, 1948.
» »	Njerëz, Njerëz dhe ngjarje, Tiranë, 1961.
—————	Këngë popullore, Këngë popullore historike, Instituti i shkencave, Tiranë, 1956.

R é s u m é

LES PARTICULES EN ALBANAIS

L'auteur donne, dans son article ci-contre, la définition et fixe les particularités lexico-grammaticales des particules, leur place et leur classement.

Les particules sont considérées comme des mots accessoires, des petits mots invariables du discours, qui servent soit à extérioriser des nuances sémantiques complémentaires (d'un mot, d'un groupe de mots ou d'un discours), soit à préciser l'attitude du sujet-parlant et à renforcer le côté affectif du parler, soit à accroître sa capacité expressive.

L'auteur fait ressortir que les particules n'ont pas un usage en soi, et n'ont, non plus, un sens lexical indépendant. Leur sens lexical est subordonné. Il ressort du contexte. Certaines particules, comme *po*, *jo*, etc., peuvent être employées aussi isolées, avec la valeur d'un discours qu'on ne peut pas démembrer et analyser en des membres particuliers. Tout de même, dans ces cas aussi le sens des particules est conditionné par le contenu du contexte.

L'auteur met en vue, dans son travail, aussi les particularités communes des particules, des prépositions, des conjonctions et des adverbes, mais dans le même temps il met l'accent aussi sur ces particularités lexico-grammaticales qui les font distinguer comme membres particuliers du discours.

L'auteur distingue, d'après la place qu'elles ont, aussi deux genres de particules: particules à place fixe ou permanente et particules à place libre. Au point de vue de l'accent, elles peuvent être accentuées (habituellement les particules à plusieurs syllabes et quelques particules monosyllabiques) ou bien inaccentuées (habituellement les particules monosyllabiques). Quelques particules monosyllabiques (*a*, *mos*, etc.) ont une fonction accentuée et inaccentuée.

D'après leur construction morphologique, les particules sont traitées comme des mots simples (*ja*, *jo*, *nuk*, *po*, *s'*, *vallë*, etc.), agglutinés (*nja*, *kushedi*, *posi*, *seç*, *thujse*, etc.) et comme locutions (*as që*, *ja që*, *jo që jo*, *pa le*, etc.). La plupart des particules de l'albanais sont sorties des parties du discours, surtout des conjonctions (*dhe*, *edhe*, *porsa*, *pra*, *sa*, *sapo*, *se*, *sikur*, etc.), des adverbes (*gati*, *plot*, *rreth*, *vetëm*, etc.) et des interjections (*a*, *e*, *ë*, *de*, etc.). Dans quelque cas, les particules ont une origine pronominale (*ç'*, *sa*) ou encore verbale (*desh*, *le*).

Toutes les particules ont été classées, d'après leur sens, en trois groupes principaux:

I. Particules exprimant des nuances sémantiques différentes.

Ces particules servent à exprimer des nuances sémantiques complémentaires d'un mot particulier, d'un groupe de mots ou d'un discours. De ce groupe font partie les particules: 1) d'indication (*ja, qe*); 2) de détermination-précision (*mu, po, porsa, që, qysh, sa, sapo, etc.*); 3) de renforcement (*dhe, edhe, madje, vetëm, sidomos, etc.*); 4) de rapprochement (*afro, aty-aty, nja, gati, rreth, thujse, etc.*).

II. Particules modales.

Ces particules servent à exprimer l'attitude du sujet-parlant envers un ou plusieurs opinions exprimées, envers la certitude d'un événement ou d'un phénomène de la réalité objective. Rentrent dans ce groupe les particules: 1) d'affirmation (*po, posi, po që po, po se po, etc.*); 2) de négation (*jo, nuk, s', mos, jo që jo, as që, etc.*); 3) d'interrogation (*a, e, ë*), 4) de doute (*ndofta, mbase, kushedi, sikur, vallë, gjë, etc.*); 5) d'atténuation (*pa, dot, le, pa, para, etc.*).

III. Particules affectives-expressives.

Ces particules servent à souligner l'aspect affectif du parler et à faire augmenter sa capacité d'expression. De ce groupe font partie les particules *ç', de, pa, pra, se, seç, etc.*

Une place particulière a été donnée aux particules formatives de mots ou grammaticales. Ces particules sont un groupe de petits mots d'origine de plusieurs parties du discours, qui, après avoir perdu les particularités lexico-grammaticales respectives, se sont transformées depuis longtemps dans des moyens analytiques pour la constitution de plusieurs formes grammaticales des mots. Telles sont *u, do, të, me, për, pa, duke*, qui sont usitées à constituer des formes grammaticales des verbes, et *më*, usitée à constituer les formes des adjectifs et des adverbes aux degrés comparatif et superlatif.